



Përditëso të dhëna dhe merr zarf të gjelbër

Për shkak të informacionit të vazhdueshëm të kursimeve dhe transparencës së sistemit, shoqëritë pensionale anëtarëve dhe fondeve pensionale me të cilat menaxhojnë, njëherë në vit u dorëzon raport për kursimet pensionale në llogaritë individuale, në llogarinë individuale vullnetare dhe në llogarinë profesionale dhe raport për portofolin investues.

Raportet për kursim pensional dorëzohen në (zarf të gjelbër) me të dhëna për vitin paraprak më së voni deri më 31 mars në vitin paraprak. Me qëllim të dorzimit të saktë dhe në kohë të raporteve të rregullta vjetore, me rëndësi të veçantë është që anëtarët e shtyllës së dytë dhe të tretë t'i përditësojnë të dhënat e tyre personale.

Raportet anëtarëve të fondeve u dorëzohen
në zarf të gjelbër.



E - MAPAS nr. 41 Prill 2022

<https://mapas.mk>



<http://www.facebook.com/mapas.mk>



<http://www.instagram.com/mapas.mk>



<http://www.linkedin.com/mapas.mk>

*“Nëse e japim maksimumin, atëherë jemi të suksesshëm. Suksesi është shfrytëzimi maksimal i mundësive që i kemi”
Zig Zigler*

*“Paratë e kursyera janë para të fituara”
Benxhamin Franklin*

*“Kur isha i ri, mendoja se paratë janë gjëra më e rëndësishme. Tani kur u plaka – atë e di”
Oskar Vajlld*

Në zarfin e gjelbër ka dy raporte:

- Raporti i parë përmban informacion për gjendjen e mjeteve në llogarinë individuale për kursimin pensional.
- Raporti i dytë përmban informacione ku janë investuar mjetet e të gjitha anëtarëve bashkë me të dhënat e detajuara për kompensimet që paguhen dhe të ardhurat e realizuara të fondit pensional.

PËRDITËSIMI I TË DHËNAVE

! Përditësimi ose korrigjimi i të dhënave mund të bëhet në njërën prej mënyrave në vijim!

PËRDITËSIMI ME KËRKESË ME SHKRIM

Duke e plotësuar Kërkesën për azhurnim/korrigjim të të dhënave personale. Për shkak të identifikimit personal të anëtarit përmes personit të autorizuar nga shoqëria ose agjenti:

- shikim të drejtpërdrejtë të dokumentit për identifikim personal të anëtarit
- kontakt telefonik me anëtarin, me ç'rast siguron incizim nga biseda.



PËRDITËSIMI PËRMES FAQES SË INTERNETIT

Përmes sistemit elektronik të faqes së internetit, shoqëria mundëson të përditësohen të dhënat: emri, mbiemri, adresa e jetesës, kodi postar, telefoni dhe posta elektronike. Gjithashtu, shoqëria siguron identifikim elektronik dhe kontroll të autorizimit të personit që dëshiron të kryejë përditësim të të dhënave.



PËRDITËSIMI PËRMES KONTAKTIT TELEFONIK

Anëtari i fondit pensional mund të azhuron/korrigjon të dhënat personale për adresën e vendbanimit edhe me një telefonat në kontakt telefonat e shoqërisë pensionale.

Shoqëria e identifikon anëtarin me ç'rast siguron incizim nga biseda.



KONTAKTI I SHOQËRIVE PENSIONALE

Shoqëria pensionale Sava sh.a.

ueb faqe: www.sava-penzisko.mk adresa: rr.

Nënë Tereza nr. 1, Shkup, telefon: 02/5100 297



Shoqëria e parë pensionale KB, SHA Shkup

ueb faqe: www.kbprvo.com.mk

adresa: rr.Mitropolit Teodosij.6, Shkup telefon:
02/3243 777



SHOQËRIA PENSIONALE SH.A Shkup

ueb faqja: www.triglavpenzisko.mk

adresa: bul. 8 Shtator nr.16, telefon:02/5102 190



Триглав пензиско друштво АД Скопје



SQARIMI I RAPORTIT PËR KURSIMIN PENSIONAL

Raporti për kursimin pensional në llogarinë individuale

Gjendja më datë: **31.12.2021**

Ju posedoni **377,929343** njësi të kontabilitetit, përkatësisht shumë totale prej **57.000** (denarë).

$$\frac{57.000 \text{ (denarë)}}{\text{(Shuma totale)}} = \frac{377,929343}{\text{(Numri i njësive të kontabilitetit)}} * \frac{150,821843}{\text{(Vlera e njësisë së kontabilitetit)}} \text{ (denarë)}$$

Paraqet numër të njësive të kontabilitetit që i posedon anëtari në llogarinë e tij.
P.sh. më 31.12.2021 anëtari posedon 377,929343 njësi

Njësia e kontabilitetit paraqet pjesë proporcionale në mjetet totale neto të fondit pensional
P.sh. më 31.12.2021 vlera e njësisë së kontabilitetit më 31.12.2021 është 150,821843 denarë

Paraqet sa mjete të kursyera ka gjithsej në llogarinë në fund të vitit
P.sh. më 31.12.2021 posedonte 57.000 denarë

KURSIMI JUJ PENSIONAL ËSHTË DEDIKUAR PËR PENSIONIN E SHTYLLËS SË DYTË- SIGURIMI I DETYRUESHËM PENSIONAL ME FINANCI M KAPITAL

Supervizor i sigurimit pensional me financim capital është Agjencia e Supervizionit të Sigurimit Pensional me Financim Kapital (MAPAS)

www.mapas.mk tel. 02 3224 229

Kontakttoni Shoqërinë tuaj pensionale (kontakt informacione)

Arkëtime/pagesa në vitin 2021

Data e pagesës	Përshkrimi	Shuma
05.01.2021	P202102	2.000
04.02.2021	P202101	2.000
05.03.2021	P202102	2.000
06.04.2021	P202103	2.000
04.05.2021	P202104	2.000
03.06.2021	P202105	2.000
07.07.2021	P202106	2.000
02.08.2021	P202107	2.000
04.09.2021	P202108	2.000
05.10.2021	P202109	2.000
03.11.2021	P202110	2.000
07.12.2021	P202111	2.000

Paraqet datë kur është bërë arkëtimi ose pagesa e mjeteve nga llogaria e anëtarit.

Paraqet shumë të kontributit të paguar.


Paraqet përshkrim të transaksionit – kontribut i paguar, korrigjim etj.
P.sh. P202109 shënon kontributin e paguar për muajin shtator 2021.
Nëse në këtë fushë ka Korrigjim, do të ceket hollësisht përshkrimi i korrigjimit. Nëse në këtë fushë ka Kthim – n, kjo shënon kthim të kontributeve (p.sh. për shkak të mjeteve të arkëtuara gabimisht).

P.sh., më datë 05.10.2021 është bërë arkëtimi i kontributit për shtator 2021 në shumë prej 2000 denarë

Gjendja fillestare shënon mjete të kursyera në vitin paraprak, ndërsa gjendja përfundimtare paraqet sa mjete të kursyera ka në fund të vitit. Nga shembulli i pasqyrës grafike mund të shihet rritja e mjeteve për kursim pensional gjatë vitit.

Informacionet për kompensimet e paguara dhe nocione të caktuara për sigurimin pensional me financim kapital (sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital, MAPAS, kontributi, të ardhurat, njësia e kontabilitetit dhe nocione tjera) janë përfshirë në faqen e dytë të Raportit për kursim pensional.

Pasqyra grafike e gjendjes së llogarisë me shumë më 31.12.2020 dhe më 31.12.2021



SQARIMI I RAPORTIT PËR PORTOFOLIN INVESTUS

Ky raport përmban të dhëna për vlerën dhe pjesëmarrjen e mjeteve të fondit pensional që janë investuar në instrumente të ndryshme financiare përfundimisht më datë 31.12.2021.

LËSHUESI	EMËRTIMI	Vlera në denarë	% mjeteve të përgjithshme
INSTRUMENTE VENDORE			
OBLIGACIONE			
xxx.....	xxx.....	xxx.....	xxx.....
RMV	Obligacion për denacionalizim RM-DEN14; 10 vite.; 2,00%; 01/06/25	100.000.000	10,00%
xxx.....	xxx.....	xxx.....	xxx.....
DEPOZITA			
xxx.....	xxx.....	xxx.....	xxx.....
STOPANSKA BANKA SHA SHKUP	3,00%,05/02/2019-05/02/2022	400.000.000	2,50%
xxx.....	xxx.....	xxx.....	xxx.....
AKSIONE			
xxx.....	xxx.....	xxx.....	xxx.....
ALLKALLOID SHA SHKUP	aksione të thjeshta	200.000.000	1,50%
xxx.....	xxx.....	xxx.....	xxx.....
LETRA ME VLERË TË LËSHUARA NGA LËSHUES ME SELI NË BE DHE OECD			
OBLIGACIONE			
xxx.....	xxx.....	xxx.....	xxx.....
xxx.....	xxx.....	xxx.....	xxx.....
AKSIONE			
xxx.....	xxx.....	xxx.....	xxx.....
COCA COLA	aksione të thjeshta	50.000.000	1,70%
GOOGLE	aksione të thjeshta	70.000.000	1,80%
xxx.....	xxx.....	xxx.....	xxx.....
FONDE INVESTUESE			
xxx.....	xxx.....	xxx.....	xxx.....
xxx.....	xxx.....	xxx.....	xxx.....
Kërkesa			
Mjete në para			
MJETET TOTALE		15.000.000.000	100,00%

Kjo do të thotë se anëtarët posedojnë 10% të mjeteve totale në obligacione për denacionalizim emetimi i 14-të në shumë prej 100.000.000 denarë.

Fondi pensional ka investuar në depozita nga Stopanska Banka sha Shkup në shumë prej 400.000.000 denarë, përkatësisht 2.50% të portofolit.

Anëtarët posedojnë 200.000.000 denarë në aksione nga Allkalloid SHA Shkup që paraqet 1.50% e mjeteve totale të fondit

Anëtarët e fondit pensional posedojnë aksione nga Coca Cola në shumë prej 50.000.000 denarë si dhe aksione nga Google në shumë prej 70.000.000 denarë.

Prona totale e fondit pensional në shembullin e dhënë është 15.000.000.000 denarë në fund të vitit për të cilin dorëzohet ky raport (31.12.2021).

Çdo anëtar i fondit pensional posedon pjesë proporcionale të kësaj shume varësisht nga shuma e mjeteve me të cilat disponon në llogarinë e paraqitur në të, ashtu siç është shpjeguar në shembullin, anëtari posedon 57.000 denarë. Çdo anëtar merr pjesë në investimet në këto instrumente proporcionalisht me mjetet e tyre.

Shoqëria pensionale dorëzon edhe pasqyra grafike për strukturën e portofolitsipasgrupittëinstrumenteve dhe sipas shtetit, pasqyrë grafike të njësisë së kontabilitetit. Të dhëna për provizionet transaksionale, provizionet që i kanë paguar për menaxhim me mjetet e fondit pensional, kompensimet që i paguan shoqëria pensionale, si dhe të ardhurat e realizuara të fondit pensional.

RISI

KOMITETI PËR STABILITET FINANCIAR : STABILITETI FINANCIAR I KURSIT

Në seancën e Komitetit për Stabilitet Financiar të mbajtur në mars të vitit 2022, u konstatua se stabiliteti i kursit të denarit është i garantuar. Sistemi financiar është gjithashtu i qëndrueshëm dhe i gatshëm për t'u përgjigjur sfidave që mund të lindin nga konflikti ruso-ukrainas, ashtu siç menaxhohen me sukses rreziqet gjatë gjithë periudhës së pandemisë. Të gjitha shërbimet financiare ofrohen pa probleme dhe do të vazhdojnë të ofrohen në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe sektorit korporativ. Rregullatorët kompetentë monitorojnë situatën në mënyrë të koordinuar dhe janë të gatshëm të veprojnë shpejt, t'i përshtasin politikat në përputhje me rrethanat dhe ta ruajnë stabilitetin financiar, gjë që është prioritet.

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve i MAPAS, Maksud Ali, theksoi se gjatë krizës shëndetësore-energjetike dhe zhvillimeve aktuale gjeopolitike, sigurimi pensional me financim kapital vepron në mënyrë stabile dhe transparente me rreziqe të identifikuara që analizohen dhe kontrollohen në baza të rregullta dhe në kuadër të rregullores, vëmendje e veçantë për investimin e mjeteve në fondet pensionale. Si pasojë e situatës së re, MAPAS monitoron me vëmendje reagimin e shoqërive pensionale në drejtim të strategjive dhe taktikave të investimit për të arritur të ardhura më të larta, vetëm në favor të anëtarëve të fondeve pensionale.

Rregullatorët financiarë do të vazhdojnë monitorimin e mëtejshëm të koordinuar të situatës dhe janë të gatshëm të reagojnë në mënyrë të duhur ndaj zhvillimeve, secili brenda kompetencave të mandatit të tij.

JAVA GLOBALE E PARAVE 2022: “NDËRTONI ARDHMËRINË TUAJ, SHFRYTËZONI PARATË ME MENÇURI

Trupi Koordinues i Rregullatorëve Financiarë për Edukimin Financiar dhe Përfshirjen Financiare, në bashkëpunim me shoqatat dhe institucionet nga sektori privat dhe civil që janë aktivë në fushën e edukimit financiar, për të dhjetën vite radhazi shënuan Javën Globale të Parasë nga data 21 deri në 27 mars 2022.

MAPAS vazhdon aktivitetet edukative për të rinjtë edhe gjatë Javës Globale të Parasë 2022, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, vendosi koordinim me rreth 40 shkolla të mesme, në të cilat së bashku me kompanitë pensionale Shoqëria e parë pensionale KB, SHA Shkup, Shoqëria pensionale Sava sh.a. Shkup dhe Shoqëria pensionale Trigla SHA Shkup mbajtën edukim financiar të studentëve për temat, kuptimin dhe ardhmërinë e parasë, nevojën për kursime dhe investime afatgjate me theks në përfitimet dhe mundësitë e sigurimit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar me financim të kapital.

Java Globale e Parasë shënohet që nga viti 2012, me një ndërprerje të vetëm në vitin 2020 për shkak të pandemisë, dhe që nga viti 2021 organizohet nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). Kjo nismë globale, e cila deri më tani është shënuar në më shumë se 176 vende të botës dhe përfshin 53 milionë fëmijë dhe të rinj, ndërgjegjëson të rinjtë për edukimin financiar dhe rrit njohuritë e tyre për paranë, kursimet, punësimin dhe sipërmarrjen. Çdo vit, të rinjtë flasin, lexojnë dhe mësojnë për sistemet ekonomike dhe financiare përmes aktiviteteve më të ndryshme që i realizojnë institucionet financiare dhe arsimore.



Keni pyetje dhe ankesa?

Lajmërohuni në MAPAS ose shkruani mesazh në contact@mapas.mk



AGJENCIA E SUPERVIZIONIT TË SIGURIMIT PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL
(MAPAS)

Stiv Naumov 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut,
tel: (02) 3224 229
<https://mapas.mk>